




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 31.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **17.08.2020**, të parashtruar nga OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521** e dt. **17.08.2020** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **03.08.2020** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjiilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës 03.08.2020**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE “ **Bejta Commerce** ” Sh.a. ,me datë **17.08.2020** , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër** ”, me nr të prokurimit **651-20-3398-5-2-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651 20 035 521**. Autoriteti Kontraktues me datë **31.08.2020** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 03.08.2020 kërkohet nga Operatorët Ekonomik që ti përmbahen kësaj të fundit :

Gjatë vlerësimit autoriteti kontraktues ka bere shkelje duke na shpall te pa pergjiegjshem per nje gabim teknik dhe ka vazhduar duke ja dhen punën kompanisë Globi MI qe ka bere shkelje shume te mëdha ligjore sepse kjo kompani e ka përdorur ing te gjeodezis ingjinerin e kompanisë sonë pa na njoftuar fare dhe gjithashtu ka nënshkruar dhe vulosur dokumente e ingjinerit me nënshkrim te falsifikuar. Te gjitha dokumentet ne dosje te tenderit per ing. Gjeodetin Iziadin Sylja janë te noterizuar nga kompania Bejta Commerce si dhe pasi e kemi konsultuar te njëjtin thot se nuk ka qene ne dijeni se janë përdorur dokumentet e tij ne tenderin ne fjale dhe nëse janë përdorur dokumentet e tij ne tenderin ne fjale dhe nëse janë përdorur thot se janë përdorur pa dijenin e tij. Gjithashtu, ne kete rast eshte tentuar te dëmtohet bugjeti i komunës per gati 30.000 euro per nje gabim teknik qe ne e kemi pas ne validitetin e ofertës gje qe kane mundur shume leht te na kërkoj ta përmirësojmë me plotësim dokumentacioni qe e lejon edhe ligji i prokurimit. Ne kohen kur eshë vlerësuar oferta ne edhe pse me gabim teknik te validiteti i ofertës kemi pasur edhe 40 dite validitet oferte dhe ka qene gjithçka ne rregull. Te makineria te pika 6 kerkesa Demolimi i kubezave ekzistuese dhe skajoreve. Kompania qe eshte zgjedhur fituese ka vendosur nje kompresor ajri qe nomal nuk i pershtatet kërkesës sepse aty eshte dashur te vendoset nje eskavator qe i demonton ansore egzistuese.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit :

Ne si AK – Autoritet Kontraktues , Komuna Gjilan duke u bazuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë kemi hartuar me pikëmirëri kërkesën për rishqytrim adresuar neve.

Qëndrojmë mbapa asaj që Komisioni Gjatë Vlersimit dhe Ekzaminimit te ofertave duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit per kontrat gjegjesisht te Periudha e vlefshmerisë se tenderit do te jete 90 dite. Ne dosjen e ofertuar nga ju Komisioni i vlersimit ka konstatuar se te periudha e vlefshmeris se tenderit ka plotsuar prej 60 dite.

Dhe jo ashtu siç është në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë, pasi dihet që kusht kryesor Administrativ është Vlefshmëria e Validitetit si dhe e Sigurimit, ju si OE nuk e keni plotësuar këtë kërkesë kryesore. Ku është e pamundur që të kërkohet sqarim rreth kësaj pike pasi që siç u cek edhe më lartë që ju si OE nuk keni plotësuar kushtin kryesor administrativ.

Ndërsa, sa i përket rreth Pretendimit tuaj që janë keqpërdorur dokumentacionet e ing. Ztr. Iziadin Sylja, ju njoftojmë që mund ti drejtoheni organeve kompetente për këtë aspekt. Ku këto të fundit mbajnë përgjegjësi për hartimin e kësaj pike.


Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi



U.D Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.